

Emri i Lëndës : Gjuhë Shqipe II							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
ALB 102	A	Pranverë	4.00	0.00	0.00	4.00	5.00
Lektori	Rahim Ombashi, Prof. Asoc. Dr.						
Asistenti							
Gjuha e kursit	Anglisht						
Niveli i lëndës	Bachelor						
Përshkrimi	Komunikimi gjuhësor është vlerë e njeriut. Vetëm njerëzit kanë aftësi të përçojnë sinjale tingëllore ose, siç thuhet ndryshe, shenja gjuhësore. Lënda e gjuhës shqipe ndihmon për të përforcuar aftësinë e të folurit me shkrim dhe gojë. Shqipja si gjuhë e shkruar dhe e folur ka sistemin e vet të veçantë shkrimor, por dhe një tërësi rregullash që formojnë strukturën e këtij sistemi. Kur analizojmë strukturën e shqipes, ndërtojmë gramatikën e saj. Përmes të mësuarit analitik dhe kritik synohet të folurit e gjuhës standard, me shkrim dhe me gojë, duke u aftësuar në ndërtimin e ligjërimit të nevojshëm						
Objektivat	Të njihet studenti me rregullat themelore të artit të të shkruarit. Të përvetësohen çështje të normës morfologjike dhe sintaksore.Të arrijnë studentët një akt të lartë komunikativ, nëpërmjet ligjërimit normativ. Të bëjnë punime me nivel të lartë gjuhësor (ese, detyra kursi dhe punim diplome). Të nxitet të vështruarit kritik dhe akti i korrektimit në rastet e devijimeve nga shqipja standarde.						
Konceptet Kryesore	1. Gjuha e djepit, ku merret formimi bazë, mbetet vlerë 2. Gjuha si mjeti kryesor i komunikimit human 3. Me gjuhë formësohet mendimi 4. Gjuha shërben për transmetimin e mendimit 5. Procesi i njohjes fillon me gjuhën 6. Nëpërmjet gjuhës prezantohet personaliteti i gjithsecilit 7. Trashëgimia gojore si themel i ligjërimit bisedor dhe bazë e gjuhës së shkruar 8. Procesi i korrektimit të jetë në vetëdijen gjuhësore, për të mos lejuar shmangiet nga ligjërimi standard ...etj.						
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	KULTURË GJUHËSORE Pjesa e tretë: Drejtshkrimi III. Norma dhe struktura gramatikore (Hyrje) Parimet e drejtshkrimit të shqipes - Struktura e rregullave të drejtshkrimit të shqipes:133-138. Memushaj, Rami. (2011) SHQIPJA STANDARDE – Si ta flasim dhe ta shkruajmë, Tiranë.						
2	Drejtshkrimi i zanoreve - Zanoret e theksuara: e, ë - Zanoret e patheksuara: e, zanorja ë paratheksore, pastheksore jofundore, fundore: 139-149. Memushaj, Rami. (2011) SHQIPJA STANDARDE – Si ta flasim dhe ta shkruajmë, Tiranë.						
3	Grupe dhe takime zanoresh - Fjalët dhe grupet ie / je - Fjalët e huaja me ia, ie, io, iu dhe ai, ei, oi, ui - Apostrofi: 150-154. Memushaj, Rami. (2011) SHQIPJA STANDARDE – Si ta flasim dhe ta shkruajmë, Tiranë.						
4	Shkrimi i bashkëtingëlloreve - Shkrimi s / z dhe i sh / zh / ç nistore - Shkrimi me j ose me i - Bashkëtingëlloret në grupet ce / ci, g e/gi (në fjalë të huaja) - Emrat e përveçëm të huaj Shkrimi i fjalëve njësh, ndaras dhe me vizë në mes - Shkrimi i fjalëve njësh - Shkrimi i fjalëve ndaras - Shkrimi me vizë lidhëse - Shkrimi me vizë të gjatë: 155-168.						
5	Përdorimi i shkronjave të mëdha - Emrat e përveçëm - Pjesët përbërëse të emërtimeve zyrtare - Emërtimet e përveçme dy – a më shumëfjalëshe: 169-174. Memushaj, Rami. (2011) SHQIPJA STANDARDE – Si ta flasim dhe ta shkruajmë, Tiranë.						
6	Nyja e përparme dhe parafjalët - Shkrimi i nyjës së përparme - Shkrimi i pjesëzave dhe i parafjalëve të përsëritura - Ushtrime: 175-188. Memushaj, Rami. (2011) SHQIPJA STANDARDE – Si ta flasim dhe ta shkruajmë, Tiranë.						

7	Koncepte themelore të gjuhësisë. Kodi, shenjat, mesazhi; Sintagma, paradigma; Njësitë e ligjëritimit; Diakronia, sinkronia; Ushtrime: 37-60. Memushaj, Rami. (2004) Hyrje në gjuhësi, Dituria, Tiranë.
8	Provimi gjysmëfinal (MIDTERM)
9	Pjesa IV: Pikësimi. - Shenjat e pikësimit - Parimet e pikësimit - Klasifikimi i shenjave të pikësimit. Shenjat e pikësimit në fund të fjalisë - Pika. Përdorime të tjera të pikës - Pikëpyetja. Pikëpyetja. Tri pikat - Përdorime të veçanta të presjes, kllapave e thonjzave - Presja. Kllapat. Thonjzat: 184-205.
10	Pikësimi i fjalisë së thjeshtë - Shenjat e pikësimit midis gjymtyrëve kryesore dhe të dyta - Gjymtyrët homogjene pa lidhëza dhe me lidhëza - Shenjat e pikësimit në fjalitë me gjymtyrë të veçuara: përcaktori i veçuar, ndajshimi i veçuar, rrethanori i veçuar. - Gjymtyrët sqaruese, plotësuese e saktësuese - Thirrori. Ndërtimet me forma të pashtjelluara. Pjesëzat pohuese, mohuese dhe dëftuese - Fjalët dhe shprehjet modale - Pashirrat dhe tingullimet: 209-222. Memushaj, Rami. (2011) SHQIPJA STANDARDE - Si ta flasim dhe ta shkruajmë, Tiranë.
11	Pikësimi i periudhës - Periudha me fjali palidhëzore Fjalitë me lidhje numërimi Fjalitë me lidhje kundërshtie Fjalitë me lidhje ftilluese: 223-226 Memushaj, Rami. (2011) SHQIPJA STANDARDE - Si ta flasim dhe ta shkruajmë, Tiranë.
12	Pikësimi i periudhës - Periudha me fjali palidhëzore Fjalitë me lidhje sqaruese e shtuese Fjalitë me lidhje shkakore Fjalitë me lidhje kushtëzimi Memushaj, Rami. (2011) SHQIPJA STANDARDE - Si ta flasim dhe ta shkruajmë, Tiranë.
13	Periudha me bashkërenditje. Periudha me nënrenditje çështjet kryesore Fjalitë përcaktore Fjalitë foljore (ftilluese e rrethanore) - Periudha me fjali të ndërmjetme dhe të ndërshtëna - Pikësimi i ligjëratës së drejtë, i dialogut dhe i citimeve Ligjërata e drejtë Dialogu Citatet dhe citimet - Ushtrime: 226-227.
14	Periudha me bashkërenditje. Periudha me nënrenditje Fjalitë foljore (ftilluese e rrethanore) - Periudha me fjali të ndërmjetme dhe të ndërshtëna - Pikësimi i ligjëratës së drejtë, i dialogut dhe i citimeve Ligjërata e drejtë Dialogu Citatet dhe citimet - Ushtrime 227-238. Memushaj, Rami. (2011) SHQIPJA STANDARDE - Si ta flasim dhe ta shkruajmë, Tiranë.
15	Përsëritje dhe konsultim
16	Provim Final
Parakushtet Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura • Rami Memushaj, SHQIPJA STANDARDE - Si ta flasim dhe ta shkruajmë, Tiranë, 2011. • Rami Memushaj, GJUHA SHQIPE NË SHTRATIN E PROKRUSTIT, Tiranë, 2013. • Bahri Beci, Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë, Tiranë: Botimet EDFA, 2004. • Rami Memushaj, Hyrje në gjuhësi, Tiranë, Botimi II, Tiranë, 2004.	
Referenca të tjera • ASHSH, Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe, Tiranë, 1973. • ASHSH, Fjalor Drejtshkrimor i Gjuhës Shqipe, Tiranë, 1976. • ASHSH, Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, Tiranë, 1980 • ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe, vol. 1 dhe 2, Tiranë, 1995, 2002. • Thomas S. Kane, Si të shkruajmë shqip, Tiranë, 2010. • Bahtijar Kryeziu, Shqipja e sotme Këndvështrim teoriko-praktik, Prishtinë, 2011. • Ali Dhrimo-Rami Memushaj, Fjalor Drejtshkrimor i Gjuhës Shqipe, tTranë, 2015.	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Të njihet studenti me rregullat themelore të artit të të shkruarit
2	Studenti duhet të kryejë punime me nivel të lartë gjuhësor (ese, detyra kursi, projekte, punim diplome)
3	Të nxitet të menduarit kritik duke u shfaqur në aktin e korrektimit në rastet e shmangies nga shqipja standarde.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	40	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			50
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	1	1
Provimi final	1	2	2
Të tjera	1	2	2
Ngarkesa totale e orëve			125
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.00
ECTS			5.00